



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 10109 Prot

Shkodër, më 16.07.2020

Lënda: Dërgohet projekt-vendimi “Për dhënie pëlqimi për dhënien me qira të sipërfaqes 10 m2 truall subjektit “Albtelekom Albania” sh.a , të sipërfaqes 10 m2 subjektit “Vodafone Albania” sh.a, të sipërfaqes 155 m2 ndërtesë subjektit Sezai Shpuza, në stadiumin “Loro Boriçi” , ndodhur në zonën kadastrale 8591, me sip. 28634 m.2, pasuria nr. 7/39, flete inventari 221, në pronësi të Bashkisë Shkodër”

KËSHILLIT BASHKIAK
SHKODËR

Të nderuar këshilltarë,

Bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim dhe miratim relacionin dhe projekt-vendimin “Për dhënie pëlqimi për dhënien me qira të sipërfaqes 10 m2 truall subjektit “Albtelekom Albania” sh.a , të sipërfaqes 10 m2 subjektit “Vodafone Albania” sh.a, të sipërfaqes 155 m2 ndërtesë subjektit Sezai Shpuza, në stadiumin “Loro Boriçi” , ndodhur në zonën kadastrale 8591, me sip. 28634 m.2, pasuria nr. 7/39, flete inventari 221, në pronësi të Bashkisë Shkodër”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin

KRYETAR


Voltana Ademi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr _____/prot

Datë ____/____/2020

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____.____.2020

“PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES 10 M2 TRUALL SUBJEKTIT “ALBTELEKOM ALBANIA” Sh.A , TË SIPËRFAQES 10 M2 SUBJEKTIT “VODAFONE ALBANIA” Sh.A, TË SIPËRFAQES 155 M2 NDËRTESEË SUBJEKTIT SEZAI SHPUZA, NË STADIUMIN “LORO BORIÇI”, NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8591, ME SIP. 28634 M.2 , PASURIA NR. 7/39, FLETE INVENTARI 221, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR”

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____.____.2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 25, nenin 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, në Ligjin nr.9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, Ligjin nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, Ligjin nr.107/2014 “Për Planifikimin dhe zhvillimin e territorit” të ndryshuar, VKM nr.421, datë 02.06.2010 “Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër, të Qarkut Shkodër” të ndryshuar, VKM nr.408 dt.13.05.2015 “Per miratimin e Rregullores se Zhvillimit te Territorit” të ndryshuar, VKM nr.500 datë 14.08.2001 për “Inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore” i ndryshuar, VKM nr 54 date 05.02.2014 "Për percaktimin e kriterëve, te procedures e te menyres se dhenies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore" të ndryshuar, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar, mbështetur në relacionin e administratës së Bashkisë Shkodër

VENDOSI

1. Të miratojë dhënien e pëlqimit për dhënien me qira të sipërfaqeve në stadiumin ‘Loro Boriçi’, ndodhur në zonën kadastrale 8591, me sip. 28634 m.2, me nr. pasurie 7/39, fletë inventari 221 në pronësi të Bashkisë Shkodër, sipas përcaktimeve më poshtë:

- sipërfaqe prej 10 m2, subjektit “Albtelekom Albania” sh.a.
- sipërfaqe prej 10 m2, subjektit “Vodafone Albania” sh.a.
- sipërfaqe prej 155 m2, subjektit Sezai Shpuza,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E KULTURËS, ARSIMIT, RINISË DHE SPORTIT

Nr. _____ Prot

Shkodër, më ____ . ____ .2020

Lënda: RELACION “PËR DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIEN ME QIRA TË SIPËRFAQES 10 M2 TRUALL SUBJEKTIT “ALBTELEKOM ALBANIA” Sh.A , TË SIPËRFAQES 10 M2 SUBJEKTIT “VODAFONE ALBANIA” Sh.A, TË SIPËRFAQES 155 M2 NDËRTESEË SUBJEKTIT SEZAI SHPUZA, NË STADIUMIN “LORO BORICË” , NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8591, ME SIP. 28634 M.2 , PASURIA NR. 7/39, FLETE INVENTARI 221, NË PRONËSI TË BASHKISË SHKODËR”

KËSHILLIT BASHKIAK

Bashkia Shkodër, bazuar në marrëveshjen ndërmjet Bashkisë Shkodër dhe Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHS) me nr. protokollit 11445, date 07.12. 2015, ka ngritur grupin e punës për të vlerësuar teknikisht zbatimin e punimeve sipas kontratës ndërmjet Federatës Shqiptare të Futbollit (FSHF) dhe subjekteve ndërtuese të stadiumit “Loro Boriçi”, Në relacionin teknik nga grupi i punës të Bashkisë Shkodër, u evidentua që:

- 1- Siperfaqja 10 m2 truall është në përdorim të subjektit *Albtelekom Albania sha*, për vendosje antene.
- 2- Siperfaqja 10 m2 truall është në përdorim të subjektit *Vodafone Albania sha*, për vendosje antene.
- 3- Siperfaqe ndërtesë 155 m2 është në përdorim të subjektit Sezai Shpuza, për ushtrim aktiviteti, ofrim shërbimesh.

Nga komunikimi me keto subjekte, na është referuar që sipërfaqja është dhënë në përdorim nga FSHF me kontratw qiraje në vitin 2018.

Stadiumi “Loro Boriçi”, i ndodhur në Zonën Kadastrale nr. 8591, me sipërfaqe 28634 m², me numër pasurie 7/39, është tërësisht në pronësi të Bashkisë Shkodër. Kjo pasuri është transferuar në pronësi të Bashkisë Shkodër me Vendim të Këshillit të Ministrave (VKM) nr 421/2010 “Per miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme), të pronave të paluejtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Shkodër , të Qarkut Shkodër”, te ndryshuar, sipas fletës së inventarit nr. 221 bashkëngjitur këtij vendimi.

Bazuar në nenin 9, pika 1.2/c të ligjit nr. 139/2015 “Per vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar , “e drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli bashkiak i cili nuk mund t’ia delegoje ushtrimin e kesaj të drejte askujt tjetër”. Në referencë të nenit 54 të ligjit të sipërcituar, kjo pronë mund të përdoret nga të tretë, vetëm pas dhenies së pëlqimit nga Keshilli Bashkiak që e ka kompetencë të vet.

“Albtelekom Albania” sh.a , të sipërfaqes 10 m2 subjektit “Vodafone Albania” sh.a, të sipërfaqes 155 m2 ndërtesë subjektit Sezai Shpuza, në stadiumin “Loro Boriçi” , ndodhur në zonën kadastrale 8591, me sip. 28634 m.2, pasuria nr. 7/39, fletw inventari 221, në pronësi të Bashkisë Shkodër”

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

KRYETAR

VOLTANA ADEMI



Konceptoi:

Drejtorja e Arsimit Kulturës, Rinisë dhe Sportit

